



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	01.09.2026
REFERENC-Ë:	26/2988/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Renelual Tahiri" SH.P.K., Prizren Bazë për prodhimin e betonit në Lubizhdë, Prizren
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për pajisje me Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/2988/MMPH, datë 01.06.2026, të operatorit "Renelual Tahiri" SH.P.K., Prizren për bazën për prodhimin e betonit në Lubizhdë, Prizren.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni :

1. Vendimi për Refuzimin e kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore për operatorin "Renelual Tahiri" SH.P.K., Prizren për bazën për prodhimin e betonit në Lubizhdë, Prizren.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR	
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org Org.Jedinica Org.Unit	01714
Nr.Prot: Broj.Prot. Prot.No.	2988-2/26
Nr. faqeve Broj.stranica No.pages	-03-
Data Datum Date	03.09.2026
PRISHTINE/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/2988/MMPH
Datë: 31.08.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 12 paragrafi 1 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nenin 8 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Renelual Tahiri" SH.P.K., Prizren, i refuzohet kërkesa me nr. prot. 26/2988/MMPH, datë 01.06.2026, për pajisje me Leje Mjedisore, për bazën për prodhimin e betonit në Lubizhdë, Komuna e Prizrenit në ngastrat kadastrale nr. 00984-3 dhe nr. 00984-5, Z.K. Lubizhdë, Komuna e Prizrenit.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin "Renelual Tahiri" SH.P.K., Prizren, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka konstatuar se Operatori nuk i plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, pasi që bazuar në raportin e rezultatit të matjes së nivelit të grimcave në ajër (Raporti Nr. 681), janë tejkalluar vlerat e lejuara të emetimeve të grimcave në ajër, më konkretisht, prania e grimcave e PM 10 pranë impiantit është $56.1 \mu\text{g}/\text{m}^3$ ndërsa vlera maksimale e lejuar e këtyre grimcave është $50 \mu\text{g}/\text{m}^3$.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i nuk i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për refuzimin e Lejes Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli
U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së



Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.